



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

ETIKA DHE ZHVILLIMI SHPIRTËROR

Titulli:

Sejjid Muxhteba Musavi LARI

Përktheu nga anglishtja:

Mentor ÇADRI



Centre International
de Traduction et de Publication
Islamique Al-Mustafâ - Qom

سرشناسه: موسوی لاری، سیدمجتبی، ۱۳۱۴ - Mujtaba, Musavi Lari
 عنوان و نام پدیدآور: Etika dhe zhvillimi shpir teror/ autori Sejjid Muxhtebe Musavi Lari; Përktheu Nga Anglishtja Mentor Çadri.
 عنوان قراردادی: رسالت اخلاق در تکامل انسان . آلبانیایی
 مشخصات نشر: Qum: Al-Mustafa International Publication And Translation Center, 2015= 1393.
 فروست اصلی: مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ﷺ پ ۱۳۹۳/۳۷۷/۲۵۹
 فروست فرعی: نمایندگی آلبانی / ۱۷
 سفارش دهنده: نمایندگی آلبانی
 شابک: ۹۷۸-۹۶۴-۱۹۵-۶۹۹-۰
 موضوع: اخلاق اسلامی
 موضوع: دین و اخلاق
 رده بندی دیویی: ۲۹۷/۶۱
 شناسه افزوده: چادری، منتور، مترجم
 شناسه افزوده: Cadri, Mentor
 وضعیت فهرست نویسی: فیبا
 رده بندی کنگره: BP۲۴۷/۸/م۸۶۵۰۴۹۵۱۳ ۱۳۹۳
 شماره کتابشناسی ملی: ۳۷۴۷۸۰۸

© Centre International de Traduction et de Publication «Al Mustafâ»

Titulli: ETIKA DHE ZHVILLIMI SHPIRTËROR

Autori: Sejjid Muxhtebe Musavi LARI

Përktheu Nga Anglishtja: Mentor ÇADRI

Redaktoi: Dorina BASHA

Korrektura Teknike: Sonila QAZIMI

Paraqitja Grafike: Fatmir SHUTINA

Botoi: Al-Mustafa International Publication And Translation Center/2015

ISBN: 978-964-195-699-0

اخلاق و رشد معنوی

مؤلف: سید مجتبی موسوی لاری

مترجم: منتور چادری

چاپ اول: ۱۳۹۳ش / ۲۰۱۵م

ناشر: مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ﷺ

● چاپ: نارنجستان ● قیمت: ۱۹۰۰۰۰ ریال ● شمارگان: ۳۰۰ نسخه

● IRAN, Qom; Muallim avenue western , (Hujjatia). Tel-Fax: +98 25-37839305 - 9

● IRAN, Qom; Boulevard Muhammad Ameen, Y-track Salariyah. Tel: +98 25-32133106,

Fax: +98 25-32133146

PËRMBAJTJE

Parathënie.....	9
Mbi jetën e autorit të librit, Sejjid Muxhteba Musavi Lari..	15

KAPITULLI I PARË

NATYRA E NJERIUT DHE ENERGGJITË E TIJ

- Njeriu zhvillohet drejt përsosurisë.....21
- Vetëpastrimi si faktor i zhvillimit.....23
- Shkaqet e krimit.....28
- Detyra më e vlefshme e njeriut.....29
- A ka kriminelë të lindur?.....33
- Natyra e pastër dhe e pamëkatë e njeriut.....36
- Liria dhe vetëpërmbytja.....43
- Zakoni dhe roli i tij konstruktiv e destruktiv.....44
- Qasja e Islamit.....49
- Fëmijëria dhe zakoni.....52

KAPITULLI I DYTË

ARSYEJA DHE NDËRGJEGJJA: DY PASURITË MË TË MËDHA TË NJERIUT

- Cilësia më e veçantë e njeriut.....57
- Kapacitetet e intelektit.....60
- A është ndërgjegjja produkt i frenimeve të brendshme?...65
- Fushëveprimi dhe roli i ndërgjegjes.....68
- Kur'ani dhe zëri i natyrës.....70
- Themeli i arsyes dhe i ndërgjegjes.....79
- Sofizmi dhe racionalizmi.....82

KAPITULLI I TRETË

RRITJA DHE ZHVILLIMI I PERSONALITETIT

- Kriteri i vlerave njerëzore.....87
- Roli themelor i natyrës shpirtërore në edukim.....95
- Zhvillimi i personalitetit në mendimin islam.....99
- Roli konstruktiv i intelektit dhe i besimit.....102
- Dëmet e mendimeve djallëzore.....115
- Marrëdhënia midis objektivave dhe zhvillimit të personalitetit.....117
- Ndërlidhja e veprimtarive psikologjike dhe fiziologjike...120

KAPITULLI I KATËRT

DETYRA SI BOSHT I JETËS

- Njeriu në mesin e detyrave.....125
- Lufta për të realizuar idealet më të larta.....127
- Përdorimi i drejtë i forcës së vullnetit.....129
- Besimi, vetëdija e detyruar dhe adhurimi.....132
- Këshilla e Lukmanit.....136
- Shkallët e vetëdijes së detyruar dhe adhurimi.....137

KAPITULLI I PESTË

MOTIVI I PAQES SË BRENDSHME

- Deti i stuhishëm i jetës.....145
- Shkaku i vuajtjeve psikike.....147
- Shqetësimi i madh për të ardhmen e panjohur.....150
- Kapja pas mjeteve shtrembëruese.....155
- Ndikimi i thellë i vuajtjeve.....158
- Roli vendimtar i besimit në paqen shpirtërore.....161
- Dorëzimi dhe kënaqësia (*Teslīm dhe Ridā*).....165
- Pritshmëritë e pakufizuara.....169
- Besimi në pavdekshmëri.....170
- Dobia nga lehtësimi i dhimbjeve të njeriut.....177
- Mbajtja lart e moralit.....178

KAPITULLI I GJASHTË

DRITA E DASHAMIRËSISË NË HORIZONTIN E JETËS

- Bazat e bashkëpunimit shoqëror.....183
- Madhështia e kënaqësive shpirtërore.....186
- Indiferenca ndaj problemeve të të tjerëve.....187
- Islami dhe marrëdhëniet shoqërore.....189
- Aspekti i dashamirësisë në Islam.....192
- Aspekti i dashamirësisë në Perëndim.....195
- Kriteri i vlerës njerëzore para Zotit.....198
- Bamirësia dhe dashuria e pakufishme.....199

KAPITULLI I SHTATË

ROLI I KUPTIMIT TË MIRËNJOHJES NË PROGRESIN SHOQËROR

- Nevojat shpirtërore të njeriut.....205
- Efekti i thellë i mirënjohjes dhe i vlerësimit.....207
- Cinizmi dhe kritika parimore.....210
- Lajkatimi është i qortueshëm.....213
- Plani i Islamit për përhapjen e virtyteve morale.....216
- Dëmet e mëdha të mosmirënjohjes.....219
- Fushata kundër veseve.....225

KAPITULLI I TETË

GUXIMI, URA DREJT FITORES

- Rruga më e shkurtër drejt suksesit.....233
- Origjina bujare e forcës.....236
- Parimet e jetës.....238
- Mësimet që nxirren nga dështimi.....238
- Mjetet e përsosurisë.....241
- Rëndësia e vetëdisiplinimit.....244
- Zbatimi i thjeshtë i Islamit nuk çon në fitore.....247
- Dy faktorë të fuqishëm edukativë.....250
- Një avantazh i shkëlqyer.....257
- Fshehja e dobësive të njeriut.....258
- Qëndrueshmëria në miqësi.....261

KAPITULLI I NËNTË

MOTIVET DHE NXITËSIT E NDRERSHMËRISË DHE TË DINJITETIT TË VËRTETË

- Nevojat psikologjike.....265
- Avantazhet dhe shkëlqimi i gënjeshtërt.....267
- Nderi sipas këndvështrimit islam.....271
- Shmangia dhe përmbajtja nga poshtërimi.....274
- Fryma e vetëbesimit.....277
- Largpamësia.....279
- Liria e vërtetë.....281
- Përafrimi i qëllimeve me kapacitetet.....282
- Poshtërimi dhe mëkati.....284
- Një gabim i madh.....287

KAPITULLI I DHJETË

LAJTHITJET E KRENARISË

- Mendimi i tepruar për veten.....291
- Pasuria dhe murrja.....295
- Murrja me të mësuarit.....296
- Veprimtaritë shkatërruese.....298
- Shëndeti shpirtëror.....300
- Mosnjohja e mangësive të njeriut.....302
- Vetëdashje, jo egoizëm.....304
- Dashuria e vërtetë dhe e qëndrueshme.....307
- Ndjenja karakteristike e dinjitetit.....308

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

MREKULLITË E FORCËS SË VULLNETIT

- Valët e ndryshimit të krijuara nga personalitetet e shquara.....315
- Mungesa e forcës së vullnetit, pengesë për arritjen e suksesit.....317
- Vigjilenca në morinë e problemeve.....319
- Fushëveprimi i mundësive njerëzore.....322
- Kriteri i përgjegjësisë sipas pikëpamjes së Islamit.....325
- Mbështetja e fuqishme e forcës së vullnetit.....327

-
- Këmbëngulja dhe fitorja.....330
 - Vetësugjestionimi.....331

KAPITULLI I DYMBËDHJETË

PARIMET E MARRËDHËNIEVE TË SHËNDETSHME SOCIALE

- Mirëqenia e sigurt shpirtërore me anë të kontakteve shoqërore frytdhënëse.....335
- Vlera e vërtetë e një miku.....338
- Ndjeshmëria dhe lëndimi.....339
- Një paralajmërim kundër shoqërisë së korruptuar..342
- Ndihma ndaj viktimave të shoqërisë së keqe.....346
- Përmbajtja në miqësi.....353
- Shtirja dhe hipokrizia.....354
- Vetmia dhe mbyllja në vetvete.....357
- Librat - miqtë më të çmuar.....358

KAPITULLI I TREMBËDHJETË

SIGURIA NË VETVETE DHE BESIMI NË ZOT

- Suksesi, një e drejtë njerëzore.....365
- Vartësia nga shpresat çorientuese.....369
- Një mësim nga i Dërguari Fisnik.....370
- Mungesa e vetësigurisë te pesimistët.....375
- Islami dhe pavarësia individuale.....376
- Përgjegjësia individuale.....378
- Kriteri i vlerës morale në veprim.....380
- Të bërit e vetes njësi matëse për gjërat.....383
- Efektet e mrekullueshme të besimit në Zot.....384

KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË
FRIKA DHE SHPRESA

- Frika.....391
- As ndrojtje, as nxitim.....395
- Mosnjohja e karakterit të jetës.....397
- Ndërthurja e frikës me shpresën te natyra njerëzore.400
- Dobësia e vullnetit.....406
- Guximi në kuptimin e tij më të gjerë.....408
- Hipokrizia, një shprehje e frikës.....411

TREGUES BIBLIOGRAFIK.....415

ME EMRIN E ALLAHUT, TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT!

PARATHËNIE

Ne vërejmë shumë qartë se gjithçka në këtë botë është në lëvizje dhe në ndryshim e sipër. Procesi i përtëritjes në jetë është parimi që qëndron në themel të ligjit të krijimit. Në të njëjtën mënyrë me të cilën besojmë në karakterin e pandryshueshëm dhe jetëgjatë të ligjit të ndryshimit, jemi gjithashtu të detyruar të besojmë në disa koncepte të pandryshueshme dhe t'i konsiderojmë ato të përhershme dhe të përjetshme. Mes këtyre parimeve të pandryshueshme janë ligjet e moralit dhe të përsosurisë njerëzore, të cilat jemi të detyruar t'i respektojmë me gjykimet e arsyes së shëndoshë dhe të drejtojmë jetën tonë në përputhje me to.

Një nga faktorët më të rëndësishëm - themelor për suksesin dhe për dështimin e një shoqërie, për triumfin dhe për rrënimin e saj - është faktori moral, roli vendimtar i të cilit në jetën e kombeve është aq shumë i dukshëm dhe i spikatur, saqë askush nuk e mohon dot.

Natyra e vërtetë e qenies njerëzore qëndron në aftësitë e pakufizuara të saj për zhvillim dhe për përsosuri. Këto kapacitete, aftësi dhe aspirata janë mishëruar dhe janë ngulitur te vetë qenia njerëzore dhe paraprijnë vetëdijen e njeriut. Sipas mendimit të edukatorëve dhe të ekspertëve trajnues, zotërimi apo kontrolli i emocioneve dhe i ndjenjave, si dhe izolimi i tyre brenda disa kufijve të moderuar është problemi më themelor i jetës njerëzore. Çdolloj zhvillimi në



aftësitë shpirtërore të njeriut duhet të konsiderohet si pasuri e qëndrueshme. Zhvillimi dhe edukimi i tyre është shumë më i rëndësishëm sesa njohuritë dhe informacionet që njerëzit grumbullojnë në nivele të ndryshme, sepse ata përdorin kapacitetet e brendshme në çdo çast të jetës së tyre.

Megjithëse drita e arsyes me rrezatimin e vet të natyrshëm ndriçon panoramën e jetës, ekziston mundësia që instinktet e lindura dhe të rrënjosura thellë te njeriu, të cilat janë burimet jetike të çdo aktiviteti në jetë dhe që duhet të jenë mjete dhe mënyra të bindura në dispozicion të arsyes, mund të dalin jashtë kontrollit. Duke u çorientuar nga boshti i tyre i vërtetë, ato mund të pengojnë vizionin e arsyes dhe të reduktojnë ndikimin e tij në një mënyrë të tillë, sa që një njeri i shkujdesur detyrohet të ndjekë prirje të cilat janë në kundërshtim me logjikën dhe interesat e tij personale. Pikërisht këtu, ne kuptojmë rolin e rëndësishëm të moralit në jetë dhe përgjegjësitë e mëdha që rëndojnë mbi shpatullat e ekspertëve në çështje të udhëzimit, të drejtimit dhe të trajnimit.

Nga ana tjetër, praktika e parimeve morale përfshin një sërë mundimesh dhe sakrificash. Shpesh ka një kontradiktë midis këtyre parimeve dhe dëshirave të forta njerëzore. Si rrjedhojë, plotësimi i këtyre dëshirave të forta bëhet i mundur vetëm nëse u kthen shpinën këtyre parimeve. Prandaj, një trajnim që e bën natyrën shpirtërore bazën e tij, nuk mund t'u rezistojë goditjeve shkatërrimtare të instinktit. Personat të cilëve u mungon mbrojtja nga natyra shpirtërore, shumë shpejt përfshihen dhe humbasin kontrollin nga erërat e dëshirave. Kjo ndodh sepse një trajnimi të tillë i mungon forca e qëndrueshme dhe jetëgjatë, që të jetë aq e aftë sa të mbajë njeriun në epërsi kundër presionit të dëshirave në të gjitha kushtet e rrethanat.

Besimi fetar është garancia më e madhe për ushtrimin e parimeve njerëzore dhe mbështetja më e madhe për vlerat etike në luftën e njeriut kundrejt pasioneve dhe instinkteve. Njeriu mund ta çlirojë veten nga kthetrat e dëshirave të forta dhe motiveve të dëmshme nëpërmjet besimit te Krijuesi,



soveraniteti i të Cilit përhapet mbi gjithësinë dhe i Cili i njeh të gjitha fshehtësitë që ekzistojnë të fshehura në çdo krijesë, si dhe nëpërmjet besimit në shpërblim apo në ndëshkim të Ditës së Gjykimit, gjithashtu, edhe me anë të ideve të pastra dhe të dobishme.

Qëllimi i profetëve, veçanërisht i Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!*) ishte edukimi dhe trajnimi i qenieve njerëzore për të arritur qëllimet më të larta dhe spastrimi i mendimeve nga ndotja dhe papastërtia.

Fushata etike e Islamit, e cila u ndërmor nga Profeti i Shenjtë (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte një lëvizje unike, e pakrahasueshme nga pikëpamja e karakterit të saj konstruktiv, e thellësisë dhe e origjinalitetit. Ajo ishte unike, në kuptimin që rrethoi të gjitha mprehtësitë e shpirtit njerëzor dhe i kushtoi vëmendje të veçantë çdo lëvizjeje të mendimit njerëzor dhe vetëdijes, që e ka origjinën e vet në qenien e brendshme të njeriut. Ndikimi i pashembullt që pati mbi psikikën njerëzore dhe realitetin e jetës ishte ngritja e njerëzve barbarë dhe të degjeneruar nga thellësitë e poshtërimin, në lartësitë e dinjitetit dhe të nderimit e respektit njerëzor. Kur iu dha llamba ndriçuese e besimit dhe e drejtimit, kjo shoqëri e degjeneruar vuri themelet e një rendi të ri në botë dhe përparoi në mënyrë të tillë në rrugën e progresit dhe të zhvillimit, sa që u bë model i moralit dhe i meritave njerëzore, një model të cilin historia nuk e ka njohur ndonjëherë. Madje, edhe në ditët e sotme, kur zbrazëtia shpirtërore lë gjurmë në karakterin dhe shpirtin e Perëndimit të shekullit XX, sa herë që njerëzit e rritur në mjedisin e tij gjejnë ngushëllim në krahët e Islamit, ndodh një ndryshim i thellë në shpirtin dhe në karakterin e tyre. Dijetarët amerikanë kanë pranuar se kur afro-amerikanët përqaftuan Islamin, të gjitha aspektet e jetës së tyre pësuan ndryshime të thella. Kjo ndodh pavarësisht nga fakti se, në shumë raste, njohuria e tyre mbi Islamin nuk është e lirë nga disa pamjaftueshmëri të caktuara.

Profesori Eric Lincoln, dekani i Fakultetit të Sociologjisë së Religjionit në një universitet amerikan, në një fjalim të mbajtur



mbi ndikimin e Islamit në Amerikë, vërejtji:

“Ndikimi i Islamit te zezakët amerikanë ka qenë i jashtëzakonshëm. Deri para se të pranonin Islamin, zezakët e hershëm jomyslimanë jetonin në kushtet më të këqija të jetesës, ndërsa tani ata kanë një nivel shumë të lartë jetese ekonomike dhe shoqërore. Mes familjeve myslimane zezake, tek të rinjtë nuk ekziston asnjë lloj devijimi dhe varësie (narkomanie), që e mbajnë shoqërinë amerikane në gjendje paniku. Madje edhe jomyslimanët e dhënë pas drogës, të cilët përqafojnë Islamin, marrin një trajnim që u bën të mundur të heqin dorë nga varësia e narkomania dhe të shndërrohen në anëtarë tepër produktivë të shoqërisë. Myslimanët zezakë amerikanë nuk janë aspak të lodhshëm dhe të mundimshëm për të tjerët. Vetëm në rastet kur tremben dhe kur sulmohen nga të tjerët detyrohen të mbrojnë veten me të gjithë fuqinë që zotërojnë. Në këtë çështje, ata kanë qenë gjithmonë të suksesshëm.”¹

Ligjet aktuale dhe sistemet ligjore mbizotëruese në botë nuk mund të depërtojnë kurrë në thellësitë e qenies së njeriut, që është burimi i veprimeve dhe i përpjekjeve të tij dhe mobilizon energjitë e tij për ndërtimin e një shoqërie të dobishme e të shëndetshme dhe për formimin e qenieve njerëzore, që zotërojnë cilësi madhështore dhe janë të pajisur me vizione kozmike.

Në radhë të parë, njeriu është përbërë nga dy parime të ndryshme: trupi dhe shpirti. Rrjedhimisht, ai ka dy dimensione: një qiellor, aspekt që është i përjetshëm dhe i qëndrueshëm, dhe një tokësor, që është jetëshkurtër dhe kalimtar apo i përkohshëm. Ata që zotërojnë mprehtësi dhe përvojë shkencore të vërtetë, e dinë mirë se këto dy aspekte janë të lidhura kaq ngushtësisht, sa që çdolloj çorientimi te njëri ndikon tek aspekti tjetër. Prandaj, çdo program që i adresohet vetëm njërit prej dimensioneve të qenies së tij, do të dështojë për arritjen e lumturisë së gjithanshme, përderisa kjo

1. E përditshmja persiane *Ittilā'āt*, nr. 14812, 26 Shahrivar, 1354 h.sh. (1975).



nuk përputhet me realitetin aktual.

Në shoqëritë e ditëve të sotme, ne nuk gjejmë ekuilibër në sistemin e të menduarit dhe të gjitha priren drejt njërit apo ekstremit tjetër. Ata ose priren tërësisht drejt aspektit material dhe të ndjeshëm apo të arsyeshëm, ose drejt aspektit intelektual dhe shpirtëror. Vëmendja e tyre përqendrohet ose tek universi, ose te njeriu. Por sistemi islam i edukimit përqendrohet mbi natyrën e përjetshme të njeriut, siç është në të vërtetë dhe e bën atë të vetëdijshëm për detyrat e tij më shumë se çdo shkollë tjetër e mendimit etik dhe edukativ. Sistemi i tij original dhe gjithëpërfshirës është tërësia e ligjeve të përgjithshme dhe të veçanta, të hartuara për ekzistencën individuale dhe shoqërore të njeriut. Me dimensionet e tij materiale dhe shpirtërore, sistemi islam bën të mundur shpëtimin dhe suksesin e njerëzimit, çka i bën individët e një shoqërie të jenë qenie njerëzore me vlera dhe të lumtur. Përmirësimi i mjedisit të njeriut duhet të fillojë nga vetja. Padyshim, një njeri që përpiqet të reformojë veten si një nga qelizat e një organizmi shoqëror dhe përpiqet të zhvillojë cilësitë e tij më të larta si dhe aftësitë e tij shpirtërore me guximin dhe durimin e këmbënguljen, do të jetë një nga ata që lufton për përmirësimin e shoqërisë, sepse një shoqëri e reformuar njerëzore është rezultat i individëve të reformuar dhe të pjekur.

Shpresojmë që përmbajtja e këtij libri, që bazohet mbi materiale nga burime të pasura islame dhe përfaqëson karakterin e mësimave fetare, si dhe prezanton pikëpamjet dhe opinionet e dijetarëve përëndimorë në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me edukimin dhe psikologjinë, do të shërbejë si një udhërrëfyes i dobishëm moral e shoqëror. Shpresojmë që ky libër do të kontribuojë në mënyrë modeste për të theksuar qëllimet e vërteta të edukimit. Do të jetë një kënaqësi shumë e madhe për mua, nëse në këtë libër do të kem sukses në shpjegimin dhe në sqarimin e një pjese të të vërtetave të mëdha të komunikuar nga udhëheqësit e njerëzimit dhe mësuesit e moralit.

Duhet përmendur se një përmbledhje e këtij libri (ndoshta



më pak se një e treta e tij) u botua në revistën prestigjioze fetare dhe shkencore “Maktab-e Islām” dhe tani i ofrohet lexuesit të nderuar në një formë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse. I lutem Zotit të Plotfuqishëm, i Cili është burimi i të gjithë qenies dhe përpara lavdisë, madhështisë dhe shkëlqimit të të Cilit, ne nuk jemi veçse murale të venitura, që të na garantojë suksesin dhe mirëqenien nën strehën e mësimave të bekuara të Islamit.

Tir, 1353 (qershor-korrik, 1974)

Sejjid Muxhteba Musavi Lari

